



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Inspektimit

Treguesit Statistikor të Tregut të Shërbimeve Postare

Tremujori 3 2025

Referenca: AKEP Statistika Shërbime Postare T3 2025

Data e publikimit: 31.12.2025

<https://akep.al/publikime/statistika/te-dhenat-dhe-treguesit-e-sherbimeve-postare/>

Rruga “Reshit Çollaku”, Tiranë, Tel: ++355 4 2259 571 www.akep.al, info@akep.al

Përmbajtje

1 . HYRJE	3
2. Treguesit kryesore të shërbimit postar	3
3.Treguesit e Shërbimit Universal Postar	6
4.Treguesit e shërbimit jo-universal postar (Ekspres dhe Jo-Ekspres)	7
Aneks 1: Numri i Objekteve postare sipas ofruesve të shërbimit postar	10
Aneks 2: Terma dhe shkurtime dhe përshkrimi i treguesve	11

1 . HYRJJE

AKEP mbledh të dhëna periodike statistikore nga ofruesit e shërbimeve postare në Shqipëri, bazuar në përcaktimet e Ligjit Nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”, e ndryshuar (Rregullore 40/2015).

Ky dokument është përgatitur nga AKEP bazuar në të dhënat e raportuara nga Ofruesi i Shërbimit Universal postar (OSHU/Posta Shqiptare) dhe Ofruesit e Tjerë të Shërbimeve Postare (OTSHP), për Tremujorin e Tretë të vitit 2025 (T3 2025) sipas formularëve përkatës të Rregullores 40/2015.

Dokumenti në vijim përmban informacion mbi tendencat të volumeve të përgjithshme të shërbimeve postare (shërbim universal dhe jo-universal postar, përfshirë shërbimin ekspres) dhe sipas llojeve kryesore të objekteve postare (Seksioni 2), ecurinë dhe strukturën e objekteve postare të shërbimit universal të ofruar nga Posta Shqiptare (Seksioni 3), ecurinë dhe strukturën e objekteve postare të shërbimit jo-universal postar, përfshirë shërbimin ekspres, nga të gjithë ofruesit e shërbimit postar (Seksioni 4).

Në Aneks 1 AKEP ka paraqitur informacion për numrin e objekteve postare (në total dhe të detajuar në postë brenda vendit, ndërkombëtare dalëse dhe ndërkombëtare hyrëse) të 20 ofruesve të shërbimit postar që kanë raportuar të dhënat statistikore për T3 2025.

2. Treguesit kryesore të shërbimit postar

Volumi i përgjithshëm i shërbimeve postare

Volumi i përgjithshëm i shërbimeve postare të ofruar nga Posta Shqiptare (në vijim, PSH) dhe Ofruesit e Tjerë të Shërbimeve Postare (në vijim, OTSHP) në T3 2025 ishte rreth 6,5 milion objekte postare, që përbën një rënie me 18% në krahasim me T2 2025 dhe 2% në krahasim me T3 2024.

Numri i objekteve postare brenda vendit ishte 5.6 milion duke shënuar një rënie me 3% në krahasim me T2 2025 dhe 10% në krahasim me T3 2024.

Numri i objekteve postare ndërkombëtare (dalëse + hyrëse) arriti në 860 mijë duke shënuar rënie prej 59% në krahasim me T2 2025 (2,1milion objekte), dhe rritje të konsiderueshme prej 102% në krahasim me T3 2024 (426 mijë objekte).

Numri i objekteve postare ndërkombëtare dalëse (të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit) në T3 2025 arriti në rreth 95 mijë, që përbën një rënie me 81% në krahasim me T2 2025 (512 mijë objekte).

Numri i objekteve postare ndërkombëtare hyrëse (të dërguara nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri) në T3 2025 arriti në rreth (764 mijë), që përbën një rënie me 51% në krahasim me T2 2025 (1.6 milion objekte).

Struktura e objekteve postare të volumit të përgjithshëm të shërbimeve sipas destinacionit/originës në T3 2025 ishte 87% objekte postare brenda vendit dhe 13 % objekte postare ndërkombëtare, krahasuar me përkatësisht 94% dhe 6% në T3 2024.

Volumi i përgjithshëm i shërbimeve postare (Shërbim Universal dhe Jo-Universal/Ekpres dhe Jo-Ekpres) të ofruar nga Posta Shqiptare ishte 4,6 milion objekte, që përbën një rënie me 10% në krahasim me T2 2025, dhe me 14 % në krahasim me T3 2024.

Volumi i përgjithshëm i shërbimeve postare (shërbim jo-universal/Ekpres dhe jo Ekpres) të ofruar nga OTSHP-të ishte 1,9 milion objekte, që përbën një rënie me 32% në krahasim me T2 2025, dhe rritje me 46% në krahasim me T3 2024.

Shërbimi Universal postar

Volumi i përgjithshëm i Shërbimit Universal në T3 2025 ishte 4,3 milion objekte, që përbën rënie me 10% krahasuar me 3 mujorin e mëparshëm T2 2025 dhe me 15% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës (T3 2024).

Raporti (pesha) i numrit total të objekteve të Shërbimit Universal (SHU) ndaj numrit total të objekteve të shërbimit postar ka vijuar trendin rënës të periudhave të mëparshme dhe arriti ishte 66% në T3 2025 krahasuar me 76% në T3 2024, ku rënia më e madhe është vënë re në peshën e numrit të objekteve ndërkombëtare të SHU ndaj totalit të objekteve ndërkombëtare që në T3 2025 arriti në 17% krahasuar me 54% në T3 2024.

Shërbimi postar jo-universal (Ekpres dhe Jo-Ekpres)

Volumi i përgjithshëm i shërbimit postar jo-universal (Jo-Ekpres + Ekspres), të ofruar nga PSH dhe OTSHP në T3 2025 ishte 2,2 milion objekte, që përbën një rënie me 29% në krahasim me T2 2025 dhe rritje 38% kundrejt T3 2024.

Volumi i përgjithshëm i shërbimeve postare (jo-universal: Ekpres dhe Jo-Ekpres) të OTSHP-ve në T3 2025 ishte rreth 1.9 milion objekte në total, që përbën një rënie me 32% në krahasim me T2 2025 dhe rritje me 46% në krahasim me T3 2024.

Numri i objekteve postare Letër të OTSHP-ve në T3 2025 ishte 183 mijë objekte, që përbën një rënie me 70% në krahasim me T2 2025, e ndikuar nga rënia e ndjeshme e numrit të letrave ndërkombëtare¹, por me rritje me 21% në krahasim me T1 2025.

Numri i objekteve postare Pako të OTSHP-ve në T3 2025 ishte 1,8 milion, që përbën një rënie me 22% në krahasim me T2 2025, por me rritje prej 23% në krahasim me T1 2025.

Pesha e objekteve postare Pako në totalin e objekteve postare të OTSHP-ve u rrit nga 78% në T2 2025 në 91% në T3 2025, për shkak të rënies së ndjeshme të numrit të letrave ndërkombëtare.

¹ Volumi shumë i lartë i letrave ndërkombëtare (dalëse dhe hyrëse) në T2 2025 ishte për shkak të të procesit të dërgimit dhe kthimit të fletëve të votimit për/nga qytetarët shqiptarë jashtë vendit në procesin zgjedhor 2025

Tabela 1: Ecuria e volumit të përgjithshëm dhe strukturës së shërbimeve postare²

Ref.	Shërbimi/Periodha	T3_2023	T4_2023	T1_2024	T2_2024	T3_2024	T4_2024	T1_2025	T2_2025	T3_2025	Ndryshimi TmT	Ndryshimi VmV
I. Numri i objekteve postare											%	%
1	Volumi i Përgjithshëm (PSH+ OTSHP)	5,455,424	6,019,463	6,147,383	6,667,394	6,660,683	5,896,692	5,582,656	7,899,713	6,495,813	-18%	-2%
1.1	Postë brenda vendit	5,142,852	5,685,664	5,847,645	6,137,160	6,234,917	5,367,766	4,727,859	5,814,970	5,636,658	-3%	-10%
1.2	Postë ndërkombëtare	312,572	333,799	299,738	530,234	425,766	528,926	854,797	2,084,743	859,155	-59%	102%
2	Shërbim Universal Postar (PSH)	4,285,367	4,705,952	4,886,419	5,311,919	5,073,620	4,018,754	3,784,061	4,803,231	4,312,142	-10%	-15%
2.1	Postë brenda vendit	4,098,479	4,522,704	4,727,732	4,942,119	4,844,980	3,797,950	3,611,633	4,469,539	4,162,338	-7%	-14%
2.2	Postë ndërkombëtare	186,888	183,248	158,687	369,800	228,640	220,804	172,428	333,692	149,804	-55%	-34%
3	Shërbim JoUniversal Postar (Ekspres+Jo-Ekspres) (PSH+OTSHP)	1,170,057	1,313,511	1,260,964	1,355,475	1,587,063	1,877,938	1,798,595	3,096,482	2,183,671	-29%	38%
3.1	Postë brenda vendit	1,044,373	1,162,960	1,119,913	1,195,041	1,389,937	1,569,816	1,116,226	1,345,431	1,474,320	10%	6%
3.2	Postë ndërkombëtare	125,684	150,551	141,051	160,434	197,126	308,122	682,369	1,751,051	709,351	-59%	260%
II. Peshë në përqindje e volumit të shërbimeve/objekteve postare											pp	pp
4	Volumi i Përgjithshëm (PSH+OTSHP)											
4.1	Postë brenda vendit/Totalit (1.1/1)	94%	94%	95%	92%	94%	91%	85%	74%	87%	13.16	-6.83
4.2	Postë ndërkombëtare/Totalit (1.2/1)	6%	6%	5%	8%	6%	9%	15%	26%	13%	-13.16	6.83
5	Shërbim Universal Postar / Volumi i Përgjithshëm (2/1)	79%	78%	79%	80%	76%	68%	68%	61%	66%	5.58	-9.79
5.1	SHU brenda vendit (2.1/1.1)	80%	80%	81%	81%	78%	71%	76%	77%	74%	-3.02	-3.86
5.2	SHU ndërkombëtare (2.2/1.2)	60%	55%	53%	70%	54%	42%	20%	16%	17%	1.43	-36.26

Figura 1: Ecuria e numrit total të objekteve postare: brenda vendit dhe ndërkombëtare




Figura 2: Objektet postare sipas ofruesve të shërbimit





Figura 3: Struktura e objekteve postare sipas shërbimeve



² Norma e ndryshimit të një treguesi me tremujorin e mëparshëm paraqitet si 'Ndryshimi TmT', ndërsa norma e ndryshimit në terma vjetorë (me të njëjtin tremujor në vitin para-ardhës) paraqitet si 'Ndryshimi VmV'. Ndryshimi TmT apo VmV i treguesve të matur në përqindje shprehet në pp (pikë përqindje).

3.Treguesit e Shërbimit Universal Postar

Ofruesi i Shërbimit Universal: Posta Shqiptare

Numri total i objekteve të Shërbimit Universal postar në T3 2025 ishte 4,3 milion objekte, që përbën rënie me 10% krahasuar me 3 mujorin e mëparshëm T2 2025 dhe me 15% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës (T3 2024).

Volumi i SHU postar brenda vendit në T3 2025 shënoi rënie me 7 % krahasuar me T2 2025 (rënie me 14% në krahasim me T3 2024) duke arritur në rreth 4.2 milion objekte në T3 2025, prej të cilave:

- 3,41 milion objekte të thjeshta, që përbën reduktim me 6% në krahasim me T2 2025
- 750 mijë objekte të regjistruara/shërbime të veçanta, që përbën reduktim prej 11% në krahasim me T2 2025.



Volumi i SHU postar ndërkombëtare (objekte postare dalëse + hyrëse) shënoi rënie me 55 % krahasuar me T2 2025 (rënie me 34% në krahasim me T3 2024) duke arritur në 150 mijë objekte në T3 2025, prej të cilave:

- 59 mijë objekteve postare ndërkombëtare dalëse SHU, që përbën rënie me 75% në krahasim me T2 2025;
- 91 mijë objekte postare ndërkombëtare hyrëse SHU, që përbën rënie me 11% në krahasim me T2 2025.

Struktura e objekteve postare të SHU sipas destinacionit/origjinës në T3 2025 ishte 97% postë brenda vendit v 3% postë ndërkombëtare, krahasuar me përkatësisht 93% v 7% në T2 2025.

Tabela 2: Ecuria dhe struktura e objekteve të SHU T2 2025-T3 2025

Ref.	Shërbim Universal Postar	T1 2025	T2 2025	T3 2025	Ndryshimi TmT
A	Shërbim universal postar (Total)	3,784,061	4,803,231	4,312,142	-10%
A1	Postë brenda vendit	3,611,633	4,469,539	4,162,338	-7%
I	Objekte të thjeshta	2,759,969	3,624,314	3,411,915	-6%
II	Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta	851,664	845,225	750,423	-11%
A2	Postë ndërkombëtare	172,428	333,692	149,804	-55%
A.2.1	Objekte postare të pranura në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit	26,424	231,609	58,949	-75%
I	Objekte të thjeshta	3,596	20,477	34,963	71%
II	Objekte të regjistruara / shërbime të veçanta	22,828	211,132	23,986	-89%
A.2.2	Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri	146,004	102,083	90,855	-11%
I	Objekte të thjeshta	75,792	56,050	42,100	-25%
II	Objekte të regjistruara / shërbime të veçanta	70,212	46,033	48,755	6%

Figura 4: Ecuria dhe struktura e objekteve të SHU sipas origjinës/destinacionit**Figura 5: Peshë e numrit të objekteve të SHU në volumin e përgjithshëm të shërbimeve postare (Total/Domestic/International)**

4. Treguesit e shërbimit jo-universal postar (Ekspres dhe Jo-Ekspres)

Ofruesit e Shërbimit Jo-Universal (Ekspres dhe Jo-Ekspres): Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Tjerë të Shërbimit Postar (OTSHP) sipas Regjistrit të Autorizimit të Përgjithshëm.

Volumi i përgjithshëm i shërbimit postar jo-universal dhe shërbimit ekspres në T3 2025 ishte 2,2 milion objekte, që përbën një rënie me 29% në krahasim me T2 2025 dhe rritje 38% kundrejt T3 2024.

Objektet postare brenda vendit të shërbimit postar jo-universal dhe ekspres në T3 2025 u rritën me 10% në krahasim me T2 2025 dhe 6% në krahasim me T3 2024, ndërsa **objektet postare ndërkombëtare** u ulën me 59% në krahasim me T2 2025 dhe u rritën në masë me 260% në krahasim me T3 2024.

Pesha e objekteve postare ndërkombëtare (jo-SHU +Ekspres) në T3 2025 arriti në 34% të numrit total të objekteve të shërbimit postar jo-universal dhe ekspres, krahasuar me 39% në T2 2025 dhe 24% në T3 2024.

Shërbimi jo-universal postar (Jo-ekspres)

Volumi i përgjithshëm i shërbimit jo-universal postar jo-ekspres në T3 2025 arriti në 456 mijë objekte, duke shënuar rënie me 49% në krahasim me T2 2025 dhe rritje me 33% në krahasim me T3 2024.

Në këtë rënie të këtij shërbimi ka ndikuar rënia e konsiderueshme numrit të objekteve postare ndërkombëtare hyrëse të raportuar nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postare: 153 mijë objekte postare (pako) ndërkombëtare hyrëse në T3 2025 krahasuar me 658 mijë objekte në T2 2025.

Shërbimi Ekspres

Volumi i përgjithshëm i shërbimit ekspres në T3 2025 arriti në 1,7 milion objekte, duke shënuar rënie me 22% në krahasim me T2 2025 dhe rritje me 39% në krahasim me T3 2024.

Në zvogëlimin e shërbimit ekspres ka ndikuar kryesisht ulja e konsiderueshme e numrit të objekteve ekspres ndërkombëtar të raportuar nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postare: 551 mijë objekte ndërkombëtare (517 mijë objekte ndërkombëtare hyrëse) në T3 2025, krahasuar me 1 milion objekte ndërkombëtare (811 mijë objekte ndërkombëtare hyrëse) në T2 2025

Posta Shqiptare

Volumi i shërbimit jo-universal postar, Jo-ekpres dhe ekspres, të ofruar nga Posta Shqiptare në T3 2025 ishte rreth 106 mijë objekte postare të shërbimit jo-universal postar jo-ekpres dhe 139 mijë objekte ekspres, të cilat janë kryesisht objekte postare brenda vendit, dhe zënë një peshë shumë të vogël si në totalin e shërbimeve të ofruara nga Posta Shqiptare (8%) dhe në totalin e shërbimit jo-universal dhe shërbimit ekspres të ofruar nga të gjithë ofruesit e shërbimit postar (11%).

Ofruesit e Tjerë të Shërbimit Postar (OTSHP)

Volumi i përgjithshëm i shërbimit jo-universal postar (Ekpres dhe Jo-ekpres) të Ofruesve të Tjerë të Shërbimit postar (në vijim, OTSHP) në T3 2025 ishte rreth 1,938 milion objekte në total, prej të cilave 1,03 milion objekte ekspres brenda vendit dhe 197 mijë objekte postare të shërbimit postar jo-universal/jo-ekpres.

Numri i objekteve të shërbimit ekspres të OTSHP-ve shënoi rënie me 23% në krahasim me T2 2025 dhe rritje me 41% në krahasim me T3 2024. Numri i objekteve postare të shërbimit jo-universal/jo-ekpres shënoi rënie me 56% në krahasim me T2 2025 dhe rritje 67% në krahasim me T3 2024.

Numri i objekteve postare Letër (objekte të korrespondencës, dokumenta etj) të OTSHP-ve në T3 2025 ishte 183 mijë objekte, që përbën një rënie me 70% në krahasim me T2 2025.

Numri i objekteve postare Pako të OTSHP-ve në T3 2025 ishte 1,756 milion, që përbën një rënie me 22% në krahasim me T2 2025. Rritjen më të madhe në bazë tremujore e shënuan pakot brenda vendit 8% dhe pakot ndërkombëtare dalëse me 10%, duke arritur në 27 mijë në T3 2025, ndërkohë numri i pakove ndërkombëtare hyrëse u reduktua me 47% në krahasim me T2 2025.

Pesha e objekteve postare Pako Total në totalin e objekteve postare të OTSHP-ve u rrit nga 78% në T2 2025 në 91% në T3 2025, për shkak të rritjes më të madhe të numrit të pakove brenda vendit dhe uljes së pakove ndërkombëtare hyrëse.

Tabela 3: Ecuria dhe struktura e volumit të shërbimit jo-universal postar (Jo-Ekspres dhe Ekspres)

Ref.	Shërbimi/Periodha	T3_2024	T4_2024	T1_2025	T2_2025	T3_2025	Ndryshimi T3_2025/ T2_2025	Ndryshimi T3_2025/ T3_2024
1	Shërbim JoUniversal Postar (Jo-Ekspres + Ekspres) (PSH+OTSHP)	1,587,063	1,877,938	1,798,595	3,096,482	2,183,671	-29%	38%
1.1	Brenda vendit	1,389,937	1,569,816	1,116,226	1,345,431	1,474,320	10%	6%
1.2	Ndërkombëtare	197,126	308,122	682,369	1,751,051	709,351	-59%	260%
1/I	Shërbim JoUniversal Postar Jo-Ekspres	343,306	361,847	218,853	890,324	455,567	-49%	33%
Form. B	Posta Shqiptare	134,420	88,162	82,974	98,724	105,974	7%	-21%
B1.	Postë brenda vendit	134,400	88,127	82,661	98,502	105,661	7%	-21%
B2	Postë ndërkombëtare	20	35	313	222	313	41%	1465%
Form. D	OTSHP	208,886	273,685	135,879	791,600	349,593	-56%	67%
A.1	Postë brenda vendit	207,415	271,470	134,372	133,563	196,673	47%	-5%
A.2	Postë ndërkombëtare	1,471	2,215	1,507	658,037	152,920	-77%	10296%
1/II	Shërbim Ekspres	1,243,757	1,516,091	1,579,742	2,206,158	1,728,104	-22%	39%
Form. B	Posta Shqiptare	120,491	131,844	134,278	134,099	138,801	4%	15%
C.1	Ekspres brenda vendit	116,750	126,695	129,139	129,356	133,984	4%	15%
C.2	Ekspres ndërkombëtare	3,741	5,149	5,139	4,743	4,817	2%	29%
Form.D	OTSHP	1,123,266	1,384,247	1,445,464	2,072,059	1,589,303	-23%	41%
B.1	Ekspres brenda vendit	931,372	1,083,524	770,054	984,010	1,038,002	5%	11%
B.2	Ekspres ndërkombëtare	191,894	300,723	675,410	1,088,049	551,301	-49%	187%

Tabela 4: Ecuria dhe struktura e objekteve postare të OTSHP-ve: Letër dhe Pako

OTSHP Letra V Pako	T1 2025	T2 2025	T3 2025	Ndryshimi TmT
Letra Total	150,786	615,982	182,704	-70%
Letra Brenda Vendit	132,445	130,202	163,816	26%
Letra Nderkombëtare Dalëse	7,023	253,161	6,964	-97%
Letra Ndërkombëtare Hyrëse	11,318	232,619	11,924	-95%
Pako Total	1,430,557	2,247,677	1,755,629	-22%
Pako Brenda Vendit	771,981	987,371	1,070,296	8%
Pako Ndërkombëtare Dalëse	287,545	24,263	26,766	10%
Pako Ndërkombëtare Hyrëse	371,031	1,236,043	658,567	-47%
Total Objekte postare	1,581,343	2,863,659	1,938,333	-32%
Pako Total/Objekte Postare Total	90%	78%	91%	13pp

Figura 6: Ecuria dhe struktura e volumit të shërbimit jo-universal postar (Jo-Ekspres dhe Ekspres)





Figura 7: Struktura e objekteve postare të OTSHP-ve: Letër v Pako



Aneks 1: Numri i Objekteve postare sipas ofruesve të shërbimit postar

Tabela më poshtë paraqet numrin e objekteve postare sipas raportimeve të 21 subjeteve postare për T3 2025, të detajuar në objekte brenda vendit, ndërkombëtare dalëse dhe ndërkombëtare hyrëse.

Tabela 5: Numri dhe struktura e objekteve postare sipas ofruesve të shërbimit postar (T3 2025)

Nr.	Ofruesi i shërbimit postar	Volumi i përgjithshëm	Postë Brenda vendit	Postë Nderkombëtare Dalese	Postë Nderkombëtare Hyrese
	Totali i raportuar T3 2025	6,495,813	5,636,658	95,375	763,780
1	Posta Shqiptare sh.a.	4,556,917	4,401,983	61,645	93,289
2	Albanian Delivery Express sh.p.k.	388,399	372,237	5,724	10,438
3	United Transport sh.p.k. (Uni Trans)	374,057	138,380	1,249	234,428
4	Ultra C.E.P. sh.p.k.	343,146	191,633	-	151,513
5	ADEX shpk	267,050	109,357	484	157,209
6	Mr. COURIER sh.p.k.	116,015	116,015	-	-
7	BIPEX sh.p.k.	115,689	44,761	5,084	65,844
8	Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex)	69,760	57,693	1,430	10,637
9	INTEX COURIER sh.p.k.	60,718	39,997	6,762	13,959
10	Elite Post sh.p.k.	56,973	56,973	-	-
11	GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.)	50,050	50,050	-	-
12	DHL International (Albania) sh.p.k.	40,310	922	12,926	26,462
13	POSTA JONË sh.p.k.	21,750	21,750	-	-
14	EXPRESS ALB 24 sh.p.k.	19,218	19,218	-	-
15	T.N.T Express Albania sh.p.k.	9,845	9,777	68	-
16	Greenposta shpk	4,975	4,975	-	-
17	Tribex Courier	937	937	-	-
18	Air Cargo Service sh.p.k. (A.C.S.)	4	-	3	1
19	Top Post sh.p.k.	-	-	-	-
20	Youth Albania Professional Services (YAPS) (Fondacion)	-	-	-	-
21	Milsped Albania sh.p.k.	-	-	-	-

Shënime:

Objektet postare në këtë tabelë përfshijnë të gjitha llojet e objekteve postare (letër, pako, etj.), objekte të thjeshta dhe të regjistruara, pjesë e objektit të Shërbimit Universal, shërbimit jo universal, përfshirë shërbimin ekspres etj..

Të dhëna statistikore për tremujorin e tretë të vitit 2025 për ofrimin e shërbimeve postare kanë raportuar 21 subjekte: Posta Shqiptare dhe 20 ofrues të tjerë të shërbimit postar. Dy subjekte përkatësisht POSTMAN sh.p.k. dhe IPOST sh.p.k. nuk kanë raportuar të dhënat statistikore për tremujorin e tretë të vitit 2025.

Aneks 2: Terma dhe shkurtime dhe përshkrimi i treguesve

Treguesi	Referenca në Formularë (Rreg.40/2015)	Përshkrim/Sqarim
Shërbim Universal (SHU)	Form. B, Kat. A.	Shërbim Universal postar është një minimum i përcaktuar shërbimesh, të një cilësie të caktuar, i mundshëm për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike, me çmime të përballueshme, sipas përcaktimeve në Ligjin 46/2015 dhe aktet përkatëse nën-ligjore.
Shërbim Ekspres	Form. B/Kat C, Form. D/Kat.B.	Është shërbim postar sipas përcaktimeve në Ligjin 46/2015 dhe aktet përkatëse nën-ligjore, që nuk është pjesë e shërbimit universal, dhe që ka si karakteristikë kryesore shpërndarjen e objekteve postare në një kohë të shpejtë/shkurtër ose të përcaktuar. Klasifikohet si shërbim me vlerë të shtuar dhe ka çmim më të lartë se shërbimet e tjera postare.
Shërbim Jo-Universal Postar Jo-Ekspres (Jo-SHU-Jo-Ekspres)	Form. B/Kat B, Form. D/Kat.A.	Shërbimi Jo-Universal Postar Jo-Ekspres, përfshin të gjitha shërbimet e tjera postare që nuk janë pjesë/klasifikohen si SHU si dhe njëkohësisht nuk janë Shërbim Ekspres. <i>Sqarim:</i> <i>Në formularët statistikorë të Rregullores 40/2015 të AKEP ky shërbim është kategori më vehte i referuar thjesht si Shërbim Jo-Universal (Kategoria B e Formularit B dhe Kategoria A e Formularit D)</i> <i>AKEP në këtë dokument përdor termin Shërbim Jo-Universal Postar dhe Jo-Ekspres (Jo-SHU-Jo-Ekspres) për ta dalluar nga Shërbimi Ekspres, i cili gjithashtu është Shërbim Jo-Universal.</i>
Postë brenda vendit (Domestic post)	Form. B/Kat. A1; B1; C1. Form. D/Kat. A1; B1.	Objekte postare të pranuar dhe shpërndara brenda vendit. (Pala dërguese dhe pala marrëse e objektit postar janë në Shqipëri).
Postë Ndërkombëtare Dalëse (International Outbound)	Form. B/Kat. A.2.1; B.2; C.2.I. Form. D/Kat. A.2.I; B.2.I.	Objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit (Pala dërguese në Shqipëri, pala marrëse jashtë vendit)
Postë Ndërkombëtare Hyrëse (International Inbound):	Form. B/Kat. A.2.2; C.2.II. Form. D/Kat. A.2.II; B.2.II.	Objekte postare të dërguara nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri. (Pala dërguese jashtë vendit, pala marrëse në Shqipëri)
Objekt Postar	Form. B Form. D. (Të gjithë treguesit)	Është një objekt i adresuar, në formën e tij përfundimtare, që dërgohet nga ofruesi i shërbimit postar ku, përveç objekteve të korrespondencës së letrave, përfshihen dhe librat, katalogët, gazetatat, revistat dhe pakot postare që përmbajnë mallra me ose pa vlerë tregtare (Ligji 46/2015, Neni 3, pika 13)
Letër	Form D/ Kat. A.1.1; A.2.I.1 A.2.II.1;B.1.1; B.2.I.1 B.2.II.1.	Objekte të korrespondencës (komunikimi me shkrim me letër), si edhe dokumenta, shtypshkrime etj., me peshë max. 2kg.
Pako	Form D/ Kat. A.1.2; A.2.I.2 A.2.II.2;B.1.2; B.2.I.2 B.2.II.2.	Objekte postare që përmbajnë mallra me ose pa vlerë tregtare me peshë max.20kg.
OSHU/USP	Form. B	Ofrusi i Shërbimit Universal (Universal Service Provider): OSHU në Shqipëri është vetëm Posta Shqiptare (PSH).
OTSHP/OPSPs:	Form. D	Ofrues të Tjerë të Shërbimeve Postar (Other Postal Service Providers): Të gjithë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare sipas Autorizimit të Përgjithshëm, përveç Ofruesit të Shërbimit Universal (Postës Shqiptare)